



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 487 Prot

Vlorë, më 03.04.2024

VENDIM

Nr. 9, datë 26.3.2024

**PËR MIRATIMIN E ANEKS – MARRËVESHJES MBI INVESTIMET
(TRANSFERTAT) MES KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE BASHKIVE TË
QARKUT**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 26.03.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 8 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 16, datë 27.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024”, të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 18, datë 29.12.2021 “Për miratimin e Akt – Marrëveshjes mbi investimet mes Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Bashkive të Qarkut” si dhe në kuadër të realizimit të investimeve në bashkitë e Qarkut Vlorë parashikuar në këtë buxhet

VENDOSI;

1. Të miratojë Aneks – Marrëveshjen mbi investimet (transfertat) mes Këshillit të Qarkut Vlorë dhe bashkive të qarkut.
2. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë Aneks - Marrëveshjen me Njësitë e Qeverisjes Vendore.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, Sektori i Financë, Buxhet dhe Shërbimeve, Sektori i Urbanistikës/Zhvillimit të Territorit/Burimeve Njerëzore/ Arsim/Kulturë/Turizëm dhe Çështjeve Sociale.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 78, pika 3 e Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 311 / Prot, datë 06.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

ANEKS – MARRËVESHJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2024

Në mbështetje të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Bashkisë _____ Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2022, në lidhje me investimet që do të kryhen nga Këshilli i Qarkut Vlorë në bashkinë _____, kërkesës së kësaj të fundit protokolluar pranë Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .202__ për financimin e projektit “ _____ ” në vlerë sipas preventivit si dhe duke synuar që kontributi i secilës palë të mundësojë përmirësimin e bashkëpunimit në territorin respektiv të njërive vendore të Qarkut Vlorë në funksion të përmirësimit të investimeve në dobi të komunitetit lidhet kjo aneks marrëveshje si më poshtë vijon :

KREU I

DISPOZITAT ME KARAKTER TË PËRGJITHSHËM

Neni 1

Qëllimi i Aneks - Marrëveshjes

Aneks - Marrëveshja ka për qëllim zhvillimin dhe realizimin e investimit të parashikuar në buxheti e Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024 në Bashkinë _____.

Kjo Aneks - Marrëveshje ka për qëllim që të jetë një mjet për realizimin e detyrave ligjore dhe nënligjore të të dy palëve, në funksion të realizimit të investimit.

Kjo Aneks - Marrëveshje ka për qëllim të krijojë kushtet e përshtatshme për bashkëpunimin ndërmjet dy palëve për të arritur synimet në funksion të realizimit të investimit.

Neni 2

Objekti i Aneks - Marrëveshjes

Objekti i rregullimit juridik në këtë kontratë është krijimi i të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet subjekteve palë në funksion të realizimit të investimit të parashikuar nga Këshilli i Qarkut Vlorë për Bashkinë _____ në buxhetin e vitit 202__ me objekt “ _____ ”.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

Këshilli i Qarkut Vlorë dhe Bashkia _____ bien dakord që të ndihmojnë njëra – tjetrën në zbatimin dhe implementimin e investimit.

Bashkia _____ dhe Këshilli i Qarkut nënshkruajnë këtë aneks – marrëveshje me afat deri në përfundimin dhe përmbushjen e plotë të investimit .

Këshilli i Qarkut merr përsipër sigurimin e fondeve për realizimin e këtij investimi dhe transferimin e tyre në llogari të Bashkisë _____.

Pagesat kundrejt Bashkisë _____ do të kryhen në momentin e parashikimit të investimit (procedurës së prokurimit) nga ky Autoritet Kontraktor.

Bashkia _____ do të informojë Këshillin e Qarkut Vlorë lidhur me ecurinë e realizimit të këtij investimi, konkretisht me ecurinë e procesit të prokurimit, lidhjes së kontratës si dhe zbatimin e saj.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 4

Kohëzgjatja, hyrja në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Marrëveshja do të zgjasë për një afat nga lidhja e saj deri në realizimin e plotë të investimit.

Kjo aneks - marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë me vullnetin e lirë të palëve.

Cdo ndryshim i saj do të bëhet në mënyrë të shkruar nga palët.

Palët bien dakord që të zgjidhin me mirëkuptim çdo problem që mund të lindë gjatë kohës së zbatimit të kësaj aneks - marrëveshje.

Neni 5

Kopjet e Aneks - Marrëveshjes

Kjo Aneks - Marrëveshje hartohet në 3 kopje origjinale dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

PËR BASHKINË _____

PËR KËSHILLIN E QARKUT VLORË

KRYETAR

Ervis Moçka
KRYETAR